



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 116
Prishtinë, më 1 dhe 5 korrik 2010

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 1 DHE 5 KORRIK 2010**

Mbledhjen e kryesoi **Jakup Krasniqi**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare.

Në fillim të mbledhjes, deputeti Gani Koci, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa propozoi që Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010, të radhitet në rend dite të kësaj mbledhje.

Kryetari kërkoi deklarinimin e kryetarëve të grupeve parlamentare lidhur me këtë propozim të deputetit Koci.

Në emër të grupeve parlamentare lidhur me propozimin e deputetit Koci u deklaruan: Ramë Buja, në emër të GP të PDK-së, Ismet Beqiri, në emër të GP të LDK-së, Ardian Gjini, në emër të GP të AAK-së, Ibrahim Makolli, në emër të GP të AKR-së, Lulzim Zeneli, në emër të GP të LDD-së, Xhezair Murati, në emër të GP “7+” dhe Branislav Grbiq, në emër të GP për Integrim.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim propozimin e kryetarit të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Gani Koci.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----59,
Kundër-----14,
Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, vendosi që Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010, të shqyrtohet, si pikë e vetme e rendit të ditës, në vazhdimin e mbledhjes plenare, më 5 korrik 2010.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 17 qershor 2010,
3. Koha për pyetje parlamentare,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit për tatimin e normës së akcizës në Kosovë,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Administratën Tatimore dhe procedurat,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për klasifikimin e informatave dhe verifikimin e sigurisë,
9. Shqyrtimi i Projektligjit për plotësim ndryshimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Për deklarime jashtë rendit të ditës u paraqitën këta deputetë: Riza Smaka, Drita Maliqi, Donika Kadaj- Bujupi, Lulzim Zeneli, Xhezair Murati, Armend Zemaj, Kaqusha Jashari, Emrush Xhemajli, Ismet Beqiri, Basri Musmurati, Naim Rustemi, Nurishahe Hulaj dhe kryeministri Hashim Thaçi, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare të mbajtur më 17 qershor 2010

Procesverbali i mbledhjes plenare, të mbajtur më 17 qershor 2010, u miratua pa vërejtje.

3. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja **Nerxhivane Dauti**, parashtroi pyetje për ministrin, Lutfi Haziri, lidhur me shkaqet e mosfunksionalizimit të Ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta.

Ministri **Haziri** iu përgjigj pyetjes së deputetes Dauti.

Deputeti **Driton Tali** parashtroi pyetje për kryeministrin, Hashim Thaçi, apo zëvendëskryeministrin, Hajredin Kuçi, lidhur me atë se për cilat çështjet të bisedimeve teknike do të bisedojnë me nivelin shtetëror të Serbisë, në të ardhmen.

Kryeministri **Thaçi** iu përgjigj pyetjes së deputetit Tali.

Deputeti **Naim Rrustemi** parashtroi pyetje për ministrin, Ahmet Shala, lidhur me kontratën ndërmjet PTK-së dhe operatorit virtual Dardafon dhe Dardafon. net, si dhe me efektet e kësaj kontrate, në vlerën e supozuar të shitjes së Vala-s.

Ministri **Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetit Rrustemi.

Deputeti **Riza Smaka** parashtroi pyetje për ministrin, Ahmet Shala, lidhur me rrezikun e mundshëm të humbjes së donacionit prej 213 milionë €, të zotuar nga Komisioni Evropian dhe Banka Botërore, për shkak të mos përmirësimeve të politikave makroekonomike në vendin tonë.

Ministri **Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

Deputetja **Nerxhivane Dauti** parashtroi pyetje për ministrin, Mahir Yagcilar, lidhur me kohën e mundshme të procedimit të Projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje, në Kuvend.

Ministri **Yagcilar** iu përgjigj pyetjes së deputetes Dauti.

Deputeti **Driton Tali** parashtroi pyetje për ministrin, Ahmet Shala, lidhur me arsyet që e shtynë Qeverinë për t'ia kufizuar buxhetin për sponzorizime dhe donacione PTK-së.

Ministri **Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetit Tali.

Deputetët: Riza Smaka, Teuta Hadri dhe Naim Rrustemi i lexuan pyetjet e parashtruara për ministrat: Edita Tahiri dhe Bujar Bukoshi, por për shkak të mosprezencës së ministrave, ata nuk morën përgjigje.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Ministri **Ahmet Shala** tha se marrëveshja e Qeverisë së Republikës së Kosovës me FMN-në shtron nevojën për amendamentimin e disa ligjeve të fushës fiskale, në mesin e të cilëve bën pjesë edhe Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Në vijim, tha se dy dokumentet e FMN-së – Letra e qëllimeve të mira dhe Programi i FMN-së përbëjnë ndryshimet e propozuara të substancës së progresit me FMN-në. Ndryshimet e propozuara janë në funksion të rritjes së transparencës dhe mbështesin punën e Kuvendit të Kosovës në rishikimin e buxhetit, konstatoi ministri.

Programi i FMN-së kërkon që të raportohet rregullisht për faturat që nuk janë paguar me kohë, kurse propozimet tjera qëndrojnë në gjenerimin e kapitalit. Ky propozim është përkrahur edhe nga Auditori i Përgjithshëm i Kosovës dhe është në pajtim me dokumentet e lartcekura të FMN-së, vuri në pah ai.

Në fund, ministri Shala ftoi deputetët për miratim, në parim, të Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Gani Koci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Hajdin Abazi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Naser Osmani, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Haki Shatri, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Riza Smaka, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Besa Gaxherri, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Myfera Shinik, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Vezira Emrush, si dhe deputetët: Bahri Hyseni, Nekibe Kelmendi, Zef Morina dhe ministri Ahmet Shala, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----52,
Kundër-----8,
Abstenime-----4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjqësi, Komisionin për Komunitete, Komisionin për Integritet Evropian dhe Komisionin për të Drejtat e Njeriut që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin më të shpejtë të mundshëm dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit për tatimin e normës së akcizës në Kosovë

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë Projektligjin për ndryshimin e Ligjit për tatimin e normës së akcizës në Kosovë.

Ministri **Ahmet Shala** tha se, duke marrë parasysh prioritetet e strategjisë së Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe marrëveshjen me FMN-në, është proces i nevojshëm mbështetja për procedimin e projektligjeve të pakos fiskale.

Në vijim, tha se ministria që ai drejton ka analizuar skenarët e ndryshëm të normës së tatimit të akcizës në Kosovë, kurse në hartimin e këtij Projektligji kanë marrë pjesë edhe përfaqësues nga komuniteti i biznesit. Një nga synimet e Qeverisë, në aspektin e politikave fiskale është edhe krijimi i një stabiliteti fiskal në vend, konstatoi ai.

Më tej, ai shpjegoi se propozimin për ngritjen e normës së akcizës për disa mallra e kemi parë si mundësi më të mirë, se sa hyrjen në detyrime tjera, siç është hyrja e vendit në borxhe.

Duke pasur parasysh trendet aktuale në treg, ne iu kemi qasur ngritjes së akcizës për disa mallra, siç janë: nafta, alkooli, duhani etj., si dhe heqjes së saj për disa mallra të tjera, siç janë: kafeja dhe gazi propan-butan.

Pas miratimit të këtij projektligji, tha ministri, besoj se do të arrihen disa efekte, por edhe zbutja e disa problemeve sociale në vend, kurse në fund ai i ftoi deputetët ta miratojnë, në parim, Projektligjin për ndryshimin e Ligjit për tatimin e normës së akcizës në Kosovë.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për ndryshimin e Ligjit për tatimin e normës së akcizës në Kosovë.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Gani Koci, në emër të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, Bahri Hyseni, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Haki Shatri, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Besa Gaxherri, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Myfera Shinik, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Vezira Emrush, si dhe deputetët: Shkumbin Demaliaj, Riza Smaka, Rexhep Hoti, Berim Ramosaj, Luljeta Shehu, Driton Tali, Fatmir Rexhepi, Gani Buçinca, Myrvete Pantina dhe ministri Ahmet Shala, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 46,
Kundër-----15,
Abstenime-----4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin e Ligjit për tatimin e normës së akcizës në Kosovë.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, , Komisionin për Komunitete, Komisionin për Integritet Evropian dhe Komisionin për të Drejtat e Njeriut që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin më të shpejtë të mundshëm dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Administratën Tatimore dhe procedurat

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë Projektligjin për Administratën tatimore dhe procedurat.

Ministri **Ahmet Shala** tha se Projektligji për Administratën Tatimore dhe procedurat është një nga Projektligjet më të rëndësishme për Administratën Tatimore, që janë nxjerrë deri më tani.

Në vazhdim, tha se FMN-ja ka vënë disa kushte që Administrata Tatimore të jetë më efikase në përmbushjen e misionit të saj.

Ky projektligj trajton ndëshkimet shtesë për implementimin e arkave fiskale, stimulimin më të mirë të inspektorëve, propozon masa për harmonizimin e këtij projektligji me Ligjin për të ardhurat tatimore etj., theksoi ai.

Më tej, tha se masat e parapara në projektligj do të ndihmojnë bizneset, kurse do të ndëshkojnë ata të cilët tentojnë shmangiet e ndryshme nga tatimet, kurse në fund i ftoi deputetët për miratimin, në parim, të Projektligjit për Administratën Tatimore dhe procedurat.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për Administratën Tatimore dhe procedurat.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, Bahri Hyseni, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Safete Hadergjonaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Xhevdet Neziraj, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Riza Smaka, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Besa Gaxherri, në emër të Grupit Parlamentar “7+” , Enis Kervan, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Vezira Emrush, si dhe deputetët: Rexhep Hoti, Adem Hajdaraj, Naim Rustemi, Fatmir Rexhepi, Driton Tali dhe ministri Ahmet Shala, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 54,

Kundër-----4,

Abstenime-----5.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për Administratën Tatimore dhe procedurat.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Komunitete, Komisionin për Integritet Evropian dhe Komisionin për të Drejtat e Njeriut që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin më të shpejtë të mundshëm dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje

Kryesuesi njoftoi Kuvendin se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Deputetja **Nerxhivane Dauti**, në emër të Komisionit funksional për të Drejtat e Njeriut, e arsyetoi Raportin me amendamentet e propozuara.

Kryesuesi i hodhi në votim, një nga një, amendamentet e komisionit funksional.

Kuvendi miratoi të gjitha amendamentet e propozuara në Projektligjin për mbrojtjen nga dhuna në familje, nga amendamenti nr. 1 deri te amendamenti nr. 11.

Kryesuesi, në vazhdim hodhi në votim tekstin e projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----61,
Kundër-----1,
Abstenime-----1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin për mbrojtjen nga dhuna në familje.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për klasifikimin e informatave dhe verifikimin e sigurisë

Kryesuesi njoftoi Kuvendin se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për klasifikimin e informatave dhe verifikimin e sigurisë dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Deputeti **Rrustem Mustafa**, në emër të Komisionit funksional për Punë të Brendshme dhe Siguri, e arsyetoi Raportin me amendamentet e propozuara.

Kryesuesi i hodhi në votim, një nga një, amendamentet e komisionit funksional.

Kuvendi miratoi të gjitha amendamentet e propozuara në Projektligjin për mbrojtjen nga dhuna në familje, nga amendamenti nr. 1 deri te amendamenti nr. 30 dhe nga amendamenti nr. 32 deri te amendamenti nr. 36.

Kuvendi nuk miratoi amendamentin nr. 31.

Kryesuesi, në vazhdim hodhi në votim tekstin e projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----63,
Kundër-----1,
Abstenime-----5.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin për klasifikimin e informatave dhe verifikimin e sigurisë.

E hënë, 5 korrik 2010, ora 10:00,

Vazhdimi i mbledhjes plenare, të filluar më 1 korrik 2010.

Kryetari, në fillim të seancës i njoftoi deputetët se sot, në mëngjes, kishte ndodhur një tentim vrasje dhe ishte plagosur deputeti i Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Petar Miletqi, të cilit i dëshiroi shërim të shpejtë.

Pastaj, kryeministri Hashim Thaçi dënoi aktin e sulmit kundër deputetit Petar Miletqi, si dhe paraqiti qëndrimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për implementimin e Strategjisë për veriun e Kosovës.

Shqetësimet lidhur me aktin e plagosjes së deputetit Petar Miletqi, si dhe mbështetjen e përfaqësuesve të komunitetit serb në integrimin e institucioneve të Kosovës, në emër të grupeve parlamentare shprehën: Sabri Hamiti, në emër të GP të LDK-së, Ibrahim Gashi, në emër të GP të AKR-së, Ardian Gjini, në emër të GP të AAK-së, Nexhat Daci, në emër të GP të LDD-së, Xhezair Murati, në emër të GP “7+” dhe Branisllav Grbiq, në emër të GP për Integrim.

Në fund, kryetari, në emër të Kuvendit kërkoi nga Qeveria e Kosovës, nga EULEX-i dhe nga institucionet e tjera që ta zbatojnë Kushtetutën dhe ligjshmërinë në tërë territorin e Kosovës.

Në vijim, Kuvendi i zhvilloi punimet sipas rendit të ditës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësim e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2010

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që ta arsyetojë projektligjin në fjalë para deputetëve të Kuvendit.

Ministri i Ekonomisë dhe i Financave, **Ahmet Shala**, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, tha se qëllimi kryesor i rishikimit të buxhetit është përshtatja e politikave ekonomike dhe akomodimi i kërkesave me prioritet për organizatat buxhetore të mbështetura në obligime ligjore apo vendime të Qeverisë.

Negociatat e gjata të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Fondin Monetar Ndërkombëtar tanimë kanë përcaktuar nivelet e caktuara të shpenzimeve dhe kursimet përkatëse për vitin 2010. Ndryshimet e propozuara me rishikim të buxhetit për vitin 2010 kanë ndikuar në rishikimin dhe plotësimin e Kornizës afatmesme të shpenzimeve për periudhën 2011 – 2013, e cila është tanimë e harmonizuar.

Në procesin e rishikimit buxhetor kemi pasur një kombinim të akomodimit të kërkesave të organizatave buxhetore brenda rregullimeve të brendshme, si dhe financime shtesë të pajtuara me Fondin për përshtatje të politikave sektoriale.

Ky rishikim ka arritur një ngritje të të hyrave prej 7,5%, e cila reflektohet edhe në kategoritë e të dalave buxhetore. Janë ngritur rezervat e buxhetit të shtetit nga 200 milionë në 241 milionë.

Procesi i rishikimit buxhetor është shënuar me rritje kualitative dhe kuantitative të indikatorëve të ndryshëm. Kjo është mundësuar nga kursimet e identifikuar që arrijnë shumën prej 51,5 milionë euro, e cila shumë rrjedh si rezultat i shkurtimeve prej 5,9 milionë euro nga kategoritë ekonomike - mallra dhe shërbime, natyrisht duke përjashtuar agjencitë e pavarura të themeluara nga Kuvendi i Kosovës, 5 milionë euro subvencione dhe transfere nga importi i energjisë, 10 milionë nga huaja KEK-ut dhe 30,6 milionë euro nga kategoria e shpenzimeve kapitale.

Duke u mbështetur në politikat e Qeverisë së Republikës së Kosovës për të përfshirë sektorin privat në disa nga ndërmarrjet publike, me këtë rishikim kemi propozuar edhe deklarinë e dividendës nga Posttelekomunikacioni i Kosovës në shumën 80 milionë euro, si dhe nga Aeroporti i Prishtinës në shumën 10 milionë euro.

Është e njohur tani se Qeveria ka marrë vendim për privatizimin e këtyre ndërmarrjeve dhe është e natyrshme që mjetet likuide që posedojnë këto ndërmarrje të jenë të vëna në dispozicion të pronarit, përkatësisht të Qeverisë së Republikës së Kosovës për financimin e projekteve me prioritet nacional.

Sa u përket financimeve shtesë, ato janë në pajtueshmëri të plotë me programin e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe shuma më e lartë është ndarë në investimet kapitale për financimin e autostradës Morinë-Merdar prej 83,7 milionë euro dhe me këtë është përmbyllur me sukses nevoja për financimin e këtij projekti për vitin 2010 prej 130 milionë euro.

Projekte tjera të rëndësishme në këtë rishikim janë edhe prodhimi i pasaportave biometrikë për qytetarët e Republikës së Kosovës prej 2,5 milionë euro, prej të cilave 1,8 milionë investime kapitale dhe 0,7 milionë në mallra dhe shërbime.

Gjithashtu, financim shtesë është bërë në sektorin e shpenzimeve operative. Kategoria e pagave në shumë prej 16,3 milionë euro, për rritje të ndodhur në këtë vit të pagave, siç është në polici, shëndetësi, është fjala për 44 euro të propozuara më herët, e cila tanimë me këtë rishikim të buxhetit merr formën institucionale të përhershme të zgjidhjes së këtij problemi të trashëguar, Forcën e Sigurisë së Kosovës, rritjen e pagave për oficerë të burgjeve, sigurimin e pagave për rritjen e numrit të oficerëve në Shërbimin Korrektues të Kosovës, si dhe pagat për funksionimin e Ministrisë së re për Integritet Evropian, e cila tanimë është funksionale.

Është financuar pjesa e dytë për financimin për vitin 2010 të Radiotelevizionit të Kosovës në shumë prej 5,2 milionë euro, si dhe janë siguruar 1 milion euro për fillimin e sigurimit të depozitave në bashkëpunim me KfV-në, pra Bankën për Zhvillim të Republikës së Gjermanisë, ku këtë vit kemi vënë 1 milion euro në dispozicion.

Rishikimi buxhetor i këtij viti është në konsistencë të plotë me programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, strategjitë zhvillimore sektoriale, nevojat dhe prioritetet imediate, si dhe politikat e hartuara nga ministrinë e linjës.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2010.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Gani Koci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Safete Hadergjona, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Naser Osmani, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Lulzim Zeneli, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Myfera Shinik, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Numan Baliq, si dhe deputetët: Sabri Hamiti, Myzejene Selmani, Mimoza Ahmetaj, Bajram Kosumi, Drita Maliqi, Synavere Rysha, Driton Tali, Fatmir Rexhepi, Besa Gaxherri, Rexhep Hoti, Haset Cakolli, Zef Morina, Zylfije Hundozi, Naser Rugova, ministri Bujar Bukoshi, Zafir Berisha, Eqrem Kryeziu, kryeministri Hashim Thaçi, Ibrahim Gashi, Qamile Morina, Abdyl Ymeri, Myrvete Pantina, Riza Smaka, Vezira Emrush, Gani Buçinca, Njomza Emini, Esat Brajshori, Gani Geci, Shkumbin Demaliaj, Ramadan Avdiu, Nurishahe Hulaj, Adem Hajdaraj, Sala Berisha- Shala dhe Drita Kadriu, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.
Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 64,
Kundër-----16,
Abstenime-----6.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2010.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Komunitete, Komisionin për Integritet Evropian dhe Komisionin për të Drejtat e Njeriut që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin më të shpejt të mundshëm dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur seancën në orën 15:50 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale